



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:015202  
Datë: 24.09.2024  
Numri i dokumentit: 06203119

**Ac.nr.10159/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.B., nga Ferizaj, rruga "...", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.F, avokat në Ferizaj, kundër të paditurës KRU "Bifurkacioni" Sh.A., me seli në Ferizaj, rruga "Enver Topalli", nr.42/A, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.A., me objekt të kontestit anulimi i vendimit dhe kompensimi i të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.116/21, të datës 15.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** e bazuar ankesa e paditësit D.B., nga Ferizaj, rruga "Ali Pashë Tepelena", **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.116/21, i datës 15.09.2021, në pikën I të dispozitivit, në pjesën që ka të bëjë me anulimin e vendimit dhe çështja në këtë pjesë gjykohet si në vijim: **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.B., nga Ferizaj, **ANULOHET** si i paligjshëm vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr. të protokollit 28, i datës 20.01.2021, i të paditurës KRU Bifurkacioni Sh.A., me seli në Ferizaj.

**II. APROVOHET** e bazuar ankesa e paditësit D.B., nga Ferizaj, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.116/21, i datës 15.09.2021, në pikën I të dispozitivit, në pjesën lidhur me kompensimin e të ardhurave personale për periudhën nga data 21.01.2021 deri me datën 30.11.2023, dhe kamatën ligjore, si dhe në pikën II të dispozitivit, ku është vendosur për shpenzimet e procedurës, ndërsa çështja për këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.116/21, të datës 15.09.2021, ka vendosur si në vijim: "I. REFUZOHET në tërësi si e pa

bazuar kërkesëpadia e paditësit D.B. nga Ferizaj Rr. "...", ushtruar kundër të paditurës KRU "Bifurkacioni" nga Ferizaj Rr. "Enver Topalli" nr.42/A, lidhur me anulimin e Vendimit Nr.28 të datës 21.01.2021 dhe kompensimin e të ardhurave personale në shumën prej 24,155.49 Euro për periudhën 21.01.2021 deri më datën 30.11.2023, me kamat prej 8% nga data 21.01.2021 deri në pagesën definitive; II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale".

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar C.nr.116/21, të datës 15.09.2021, ta ndryshoj ashtu kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 pika c) dhe e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi përmes të autorizuarit, me datën 28.01.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtuar padi kundër të paditurës KRU "Bifurkacioni" Sh.A. me seli në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësin ta rikthejë në vendin e tij të punës dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale nga data 21.01.2021, deri në pagesën definitive. Në padi paditësi ka theksuar se tek e paditura me kontratë pune ka themeluar marrëdhënien e punës me afat tre vjeçar, ndërsa të e paditura ka punuar nga data 01.12.2020 deri me datën 21.01.2021 ku me vendim arbitrar të Bordit të Drejtorëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me arsyetimin se gjatë procesit të rekrutimit të kandidatëve është bërë shkelje e dispozitave ligjore dhe shkelje e të drejtave të kandidatëve të tjerë në procesin e rekrutimit. Pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare, përmes parashtrësës së datës 14.09.2021, dhe në seancën shqyrtimit kryesor të datës 15.09.2021, paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë në tërësi si të bazuar. E paditura përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i ligjshëm pasi që zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarinimin e arsyes.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadiës së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.116/21, të datës 15.09.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga provat e administruara ka rezultuar se nuk ishte kontestues fakti që e paditura ka shpallur konkurs për një vend të lirë të punës në pozitën sekretar i kompanisë, që paditësi ka marrë më së shumti pikë nga komisioni rekrutues për pozitën sekretar i kompanisë, fakti që përmes vendimit të datës 27.11.2020 paditësi është pranuar në punë tek e paditura, përmes kontratës së punës ka themeluar marrëdhënien e punës me kohë të caktuar, e nuk ishte kontestues as fakti që paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga e paditura. Megjithatë në arsyetim gjykata e shkallës së parë thekson pas vërtetimit të gjendjes faktike ka gjetur se qëndrojnë pretendimet e palës së paditur së procedura e përzgjedhjes së paditësit në pozitën sekretari i kompanisë është përcjellë me parregullsi gjatë formimit të komisionit rekrutues, më decidivisht për arsyet si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar. Andaj, sipas vlerësimit të gjykatës kontrata e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës është rezultat i një procedure të rekrutimit të zhvilluar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 07/2017 dhe nenin 21 të Ligjit për Marrëdhëniet Publike, ndërsa vendimi i datës 21.01.2021 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i bazuar në kompetencën e Bordit të Përkohshëm të paraparë me nenin 177 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe në neni 67 par.1.9 të Ligjit të Punës. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket anulimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është e bazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë të ndryshohet, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Si rrjedhojë, Gjykatës se Apelit, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, i rezultoi së Bordi i Drejtorëve i të paditurës, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.09.2020, kishte marrë vendim për shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës për pozitën Sekretar i KRU Bifurkacioni, dhe Zyrtar Kryesor i Financave, ndërsa nuk ishte kontestuese së paditësi kishte marrë pjesë në këtë konkurs si kandidat për pozitën Sekretar i KRU Bifurkacioni. Me datë 16.11.2020, e paditura kishte njoftuar për rezultatet finale për pozitën e shpallura sipas konkursit, ku theksohej së kandidatët të cilën kanë më së shumti pikë janë fitues të konkursit në pozitën respektive, ndërsa ishte dhënë këshillë juridike për kandidatët e pakënaqur sipas të cilës të njëjtit mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 (tetë) ditësh nga data e shpalljes së rezultateve. Kolegji

gjeti së Bordi i Drejtorëve i të paditurës, duke u bazuar në rezultatet e testit me shkrim, intervistimit dhe propozimit të Komisionit përzgjedhës –intervistues të bazuar në procesverbalin me nr. protokollit 1885, të datës 16.11.2020, dhe vendimit të të njëjtit komision me nr. protokollit 1886, të datës 16.11.2020, me datë 27.11.2020, ka marrë vendim me të cilin paditësi është pranuar në punë dhe detyra të punës Sekretar i kompanisë, sipas të cilit vendim paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me kohë të caktuar, duke filluar nga data 01.12.2020, deri me datë 01.12.2023, me afat 3 (tre) vjeçar. Ndërsa duke u bazuar në nenin 10 paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, si në nenin 11 të Ligjit të Punës, me datë 30.11.2020, paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë punë për kohë të caktuar, duke filluar nga 01.12.2020, deri me 01.12.2023, me afat 3 (tre) vjeçar, në vendin e punës Sekretar i kompanisë.

Kolegji i kësaj gjykate gjeti së Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i të paditurës, me datë 20.01.2021, ka marrë vendim me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si Sekretar i kompanisë, i cili vendim ka hyrë në fuqi me datë 21.01.2021. Në arsyetim të vendimit si arsye për ndërprerjen e marrëdhënies së punës theksohet së Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ka hasur në parregullsi në rekrutimin e zyrtarëve të lartë në konkursin e shpallur me datë 01.10.2020, për pranimin në punë të zyrtarëve Sekretar i Kompanisë dhe Zyrtarë Kryesor i Financave dhe Thesar. Sipas Bordit këto parregullsi konsistojnë në formimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve, të rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 7, paragrafi 3 dhe neni 4 paragrafi 6, pasi që në komisionin përzgjedhës prej 3 anëtarëve, bazuar në procesverbalet e raporteve mujore të Bordit të Drejtorëve, dy prej tyre nuk kanë qenë prezentë në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, që nga muaji mars i vitit 2020, dhe nuk kanë qenë prezentë edhe në testimin dhe intervistimin në rekrutimin e kandidatëve për këto dy pozita. Tutje sipas arsyetimit të Bordit të Përkohshëm si parregullsi tjetër dhe shkelje e rëndë e dispozitave ligjore, në procesverbalin me nr.1885, datë 16.11.2020, për shpalljen e rezultateve finale të kandidatëve, dhe në vendimin me nr.1886, datë 16.11.2020, për përzgjedhjen e kandidatëve ka nënshkruar Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve pa qenë anëtar i këtij komisioni dhe pa marrë fare pjesë në përzgjedhjen e kandidatëve. Bazuar në këtë Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve ka konstatuar shkelje të të drejtave të kandidatëve tjerë në këtë konkurs dhe shkelje në formimin dhe procedurave në punën e komisionit gjatë rekrutimit të tyre, dhe duke u bazuar në nenin 21.1 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ka vendosur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit.

Nga shqyrtimi i provave të theksuara më lartë dhe shqyrtimi i të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket anulimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është e bazuar, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, e paditura ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit në mënyrë të paligjshme. Kjo për faktin së është vërtetuar së paditësi është pranuar në punë në pozitën Sekretar i kompanisë, në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të datës 27.11.2020, i cili vendim ishte marrë në bazë propozimit të Komisionit përzgjedhës–intervistues, sipas të cilit paditësi në bazë të rezultateve të treguar gjatë testimit me shkrim dhe intervistimit ka treguar njohuri adekuate dhe ka pasur përgatitje profesionale dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet për tu pranuar në këtë pozitë. Bazuar në këtë vendim paditësi me të paditurën me datë 30.11.2020, kanë lidhur kontratë punë për kohë të caktuar, duke filluar nga 01.12.2020, deri me 01.12.2023, me afat 3 (tre) vjeçar, në vendin e

punës Sekretar i kompanisë, ndërsa Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i të paditurës me vendimin e datës 20.01.2021, i ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, me efekt nga data 21.01.2021, me arsyetimin së ka gjetur parregullsi në fazës e rekrutimit për pranimin në punë të paditësit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, vendimi me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës është i paligjshëm, pasi që arsyet që janë dhënë në këtë vendim nuk përbëjnë bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Kjo për faktin së e paditura nuk ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit për shkak të performancës së pakënaqshme apo shkeljeve tjera të detyrave të punës siç përcaktohet me kontratën e punës dhe Ligjin e Punës, por për shkak të parregullsitë që kanë ndodhur gjatë fazës së rekrutimit edhe përkundër faktit së paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune me të paditurën. Kolegjit vlerëson së, çfarëdo parregullsie që ka ndodhur gjatë fazës së rekrutimit çoftë në përbërjen e komisionit përzgjedhës apo shkeljet tjera eventuale, ka mundur të shqyrtohen nga e paditura apo nga gjykata në rast të paraqitjes së ankesës të ndonjërit nga kandidatët i cili ka marrë pjesë në konkurs, ashtu siç ishin udhëzuar nga e paditura me rastin njoftimit për rezultatet finale për pozitën e shpallura sipas konkursit. Andaj, konstatimi i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve së ka pasur shkelje të të drejtave të kandidatëve në konkurs nuk mund të pranohet si arsye për ndërprerjen e kontratës së punës paditësit, pasi që kandidatëve tjerë nuk i është mohuar e drejta për të paraqitur ankesë apo padi në gjykatë në rast së kanë qenë të pakënaqur me rezultatin përfundimtar dhe me procedurën e rekrutimit.

Meqenëse paditësi pas përfundimit të procedurës së testimit dhe intervestit ka rezultuar si kandidat i suksesshëm dhe me të paditurën me vullnetin e lirë ka lidhur kontratë punë për përdhë të caktuar, ku janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e punës dhe shkaqet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi, e paditura në këtë rast nuk ka pasur të drejtë që paditësit t'i ndërpresë kontratën e punës për shkak parregullsive që kanë ndodhur në formimin dhe përbërjen e komisionit gjatë fazës së rekrutimit, pasi që në këtë rast nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paraparë me nenin 15 të kontratës së punës dhe nenin 70 të Ligjit të Punës. Për me tepër, procedurën e rekrutimit e ka udhëhequr e paditura dhe nuk ka qenë në përgjegjësinë e paditësit që të kujdeset nëse komisioni rekrutues është formuar sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ, pasi që për ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit është dashur që të kujdeset e paditura para nënshkrimit të kontratës së punës me paditësin. Në këtë kontekst për shkeljet të cilat i ka konstatuar Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, ka mundur eventualisht që të mbahen përgjegjës personat që i kanë lejuar që të ndodhin këto shkelje, por kjo nuk i jep të drejtë të paditurës që paditësit për këto shkelje zyrtarisht t'ia ndërpres marrëdhënien e punës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkeljet e bëra gjatë fazës së rekrutimit siç ka vepruar e paditura, do të kishte bazë ligjore vetëm në rast së do të ishte anuluar konkursi nga e paditura apo gjykata sipas ankesës së paraqitur nga ndonjëri nga kandidatet që ka marrë pjesë në konkurs. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar ka vendosur që kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar, duke konstatuar së procedura e përzgjedhjes së tij në pozitën sekretar i kompanisë është përcjellë me parregullsi gjatë formimit të komisionit rekrutues. Kjo pasi që në rastin konkret nuk ka qenë objekt shqyrtimi ligjshmëria e procedurës së rekrutimit por ligjshmëria ndërprerjes së marrëdhënies së punës duke pasur

parasysh faktin së paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës pas themelimit të marrëdhënies së punës (lidhjes së kontratës së punës), andaj gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësoj nëse janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa u lëshuar në vlerësimin e shkeljeve që kanë mundur të ndodhin gjatë fazës së rekrutimit, sepse procedura e rekrutimit ka mundur të jetë objekt shqyrtimi në gjykatë vetëm në rast së ndonjëri nga kandidatet e pakënaqur do të kishte paraqitur padi me pretendim së kanë ndodhur shkelje gjatë përzgjedhjes së kandidatit fitues.

Gjykata e Apelit, vlerëson së gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që dispozita e nenit 67 par. 1, nënpar. 1.9 e Ligjit të Punës, i referohet rasteve kur kontrata e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore, ndërsa në rastin konkret paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës jo sipas fuqisë ligjore por me vendim të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve, të cilin vendim e ka bazuar në nenin 21 par.1 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit është paraparë së *“Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarëve për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarin e arsyes. Ky Nen 21.1 mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, dhe do të pasqyrohet në Rregulloren e NP-së”*.

Gjykata e Apelit, në rastin konkret pati parasysh dispozitën e lartcekur sipas së cilës Bordi i Drejtorëve mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e Zyrtarit të NP me ose pa deklarin e arsyes dhe rregullimin së kjo dispozitë mbizotëron mbi çdo dispozitë kontraktuese të themeluar me kontratë ose ligj, mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj gjykate mos deklarimi i arsyeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës duhet të interpretohet në atë mënyrë që në rastet e tilla nuk është e domosdoshme që të zhvillohet procedura disiplinore siç përcaktohet me Ligjin e Punës, megjithatë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës duhet të ketë arsyetim sepse ndërprerja e marrëdhënies së punës nga punëdhënësi pa dhënë arsye konsiderohet si vendim arbitrarë dhe shkelje e drejtave të punësuarit. Në rastin konkret vendimi me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës është i arsyetuar, mirëpo, siç është theksuar me sipër arsyet e dhëna në këtë vendim nuk përbëjnë bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke marrë parasysh faktin së paditësi ka pasur të themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, ndërsa i është ndërprerë marrëdhënia e punës me arsyetimin së ka pasur parregullsi në formimin e komisionit rekrutues.

Prandaj, për Gjykatën e Apelit, arsyet për të cilat paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës janë të papranueshme sepse nëse pranohet ky standard që punëdhënësi zyrtarisht dhe në çdo kohë ta shqyrtoj ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit dhe të themelimit të marrëdhënies së punës, do të vije deri të cenimi i sigurinë juridike dhe shkelja e të drejtave të të punësuarit, pasi që i punësuarit vazhdimisht do të ishte nën presion që punëdhënësi në çdo kohë mund t'i ndërpresë marrëdhënien e punës me arsyetimin së përbërja e komisionit gjatë fazës së rekrutimit nuk ka qenë sipas ligjit, pavarësisht faktit së nuk ka qenë nën përgjegjësinë e të punësuarit që të kujdeset

për përbërjen e komisionit rekrutues. Megjithatë, ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkeljet e bëra gjatë fazës së rekrutimit siç ka vepruar e paditura, do të kishte bazë ligjore vetëm në rast së do të ishte anuluar konkursi nga e paditura apo gjykata sipas ankesës së paraqitur nga ndonjëri nga kandidatet që ka marrë pjesë në konkurs, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret. Andaj duke qenë së paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të performacës së pakënaqshme apo për shkak të shkeljeve të detyrave të punës siç përcaktohet me nenin 15 të kontratës së punës dhe nenin 70 të Ligjit të Punës, Gjykata e Apelit vlerëson së vendimi i të paditurës është i paligjshëm, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që aktgjykimi i atakuar në pjesën që i referohet kompensimit të ardhurave personale për periudhën nga data 21.01.2021 deri me datën 30.11.2023, është marrë me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së. Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike sa i përket kompensimit të ardhurave personale ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare të datës 02.09.2021, të përpiluar nga eksperti A.K., sipas të cilën ekspertizë është bërë llogaritja pagave neto dhe kontributit pensional të cilat paditësi do t'i realizonte të e paditura për periudhën prej muajit 1/2021 kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në muajin 8/2021, kur është përpiluar ekspertiza financiare, ku është konstatuar së pagat neto së bashku me kontributin pensional arrin shumën prej 5,183.88 euro, ndërsa në variantin e dytë është bërë llogaritja pagave neto dhe kontributit pensional të cilat paditësi do t'i realizonte për periudhën prej muajit 1/2021, kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në muajin 11/2023, kur do të përfundonte kontrata e punës e paditësit, ku është konstatuar së pagat neto së bashku me kontributin pensional për këtë periudhë arrin shumën prej 24,155.49 euro. Duke qenë së paditësi ka kërkuar kompensimin e të ardhurave personale sipas variantit të dytë për përdhën nga data 21.01.2021 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës e deri me datën 30.11.2023, ku do të skadonte kohëzgjatja e kontratës së punës, Gjykata e Apelit, vlerëson së në këtë rast nuk është bërë vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, kjo duke marrë parasysh faktin së ekspertiza financiare është përpiluar me datë 02.09.2021, ndërsa llogaritja e të ardhurave personale në variantin e dytë është bërë edhe pas datës së ekspertizës, përkatësisht deri me datë 30.11.2023, kur do të përfundonte kontrata e punës. Andaj, në këtë rast ka mbetur pa u vërtetuar fakti nëse paditësi gjatë periudhës sa ka qenë kohëzgjatja e kontratës ka realizuar të ardhura nga ndonjë punëdhënës tjetër. Për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që i referohet kompensimit të të ardhurave personale dhe kamatës, u deshtë që të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje, ngase gjykata e shkallës së dytë në mungesë të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike nuk ka pasur mundësi që në këtë pjesë të njëjtin ta ndryshoj. Gjykata ankimore ka kthyer në rigjykim edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës pasi që shpenzimet e procedurës duhet të gjykohen në mënyrë unike për tërë procesin gjyqësor dhe sipas suksesit në procedurë.

Në riprocedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që ta caktoj seancën e shqyrtimit kryesor ashtu që fillimisht ta kthej ekspertizën financiare në plotësim në atë mënyrë që t'i jepet detyrë ekspertit financiar që pas verifikimit të llogarisë pensionale të paditësit në Trust, të konstatoj nëse paditësi gjatë periudhës nga data 21.01.2021 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës e deri me datën 30.11.2023, ku do t'i skadonte kohëzgjatja e kontratës së punës, ka realizuar të

ardhura nga punëdhënës tjerë, dhe nëse eventualisht konstatohet së paditësi ka realizuar të ardhura nga punëdhënës tjerë atëherë të llogaritet diferenca në mes pagave neto që paditësi do t'i realizonte tek e paditura dhe pagave neto që i njëjti i ka realizuar të punëdhënësit e tjerë, dhe të konstatoj në mënyrë të veçantë sa është vlera e kontributi pensional që paguhet në Trust, dhe e tatimit në pagë që paguhet në ATK, dhe me pastaj të ftoj paditësin që ta bëjë rregullimin e kërkesëpadiisë duke u kujdesur që të bëhet e qartë shuma që kërkohet në emër të pagave neto, dhe shumën që kërkohet në emër të kontributit pensional, dhe periudha për të cilën kërkohet, e pas kësaj gjykata përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadiinë e paditësit. Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195, paragrafi 1, pika c) dhe e) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.10159/2021, datë 11.09.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci